



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/ 02-10290/22
Kaçanik, 29.04.2022

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 20 pika 1, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, të nenit 6 pika 3 paragrafi 1, pikës 9 të Udhëzimit Administrativ (MASH) me Nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, të Propozim Vendimi të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-10290/22 prej datës 14.04.2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 Prill 2022, mori këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS PËR DREJTOR
TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Propozim Vendimi i Drejtorisë së Arsimit (DA) 01Nr. 104/02-10290/22- Për emërimin e Komisioni përzgjedhës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për kandidatët që konkurrojnë për vende të lira të punës: Drejtor të Institucioneve Arsimore në Komunën e Kaçanikut, në këtë përbërje:

- 1.1. Hajrush Dullovi, Kryetar i komisionit, Zyrtar i lartë i arsimit;
- 1.2. Arlinda Elezi, Anëtare, Zëvendës drejtoreshë në SHFMU "Emin Duraku"; dhe
- 1.3. Një(1) përfaqësues i MASH-it, Anëtar.

2. Dy përfaqësues të Këshillit drejtues nga IEAAP, në cilësinë e vëzhguesve, një prind dhe një mësimdhënës.

3. Komisioni përzgjedhës do të veprojë sipas udhëzimeve të parashikuara, respektivisht Udhëzimit Administrativ (MASH) me Nr. 151/2020.

4 Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, ndërkaq vlen për një vit shkollor.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria e Arsimit dhe mekanizmat tjerë relevantë.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Arsimit; dhe
3. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kačanik
Municipality Kacanik

Kryetari i Komunës
01 .Nr. 104/02-10290 2022
Kaçanik, 14.04.2022

Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 20 pika 1, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ(MASh) me Nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Kryetari i Komunës, bënë këtë;

PROPOZIM - V E N D I M

Për emërimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të Institucioneve Arsimore

1. Emërohet komisioni përzgjedhës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për kandidatët që konkurrojnë për vende të lira të punës: Drejtor të Institucioneve Arsimore në Komunën e Kaçanikut, në këtë përbërje:

- 1.1.Hajrush Dullovi, Kryetar i komisionit, zyrtar i lartë i arsimit,
- 1.2.Arlinda Elezi, anëtare, zëvendësdrejtoreshë në SHFMU "Emin Duraku" dhe
- 1.3 . Një përfaqësues i MASh-it, anëtar.

2. Dy përfaqësues të Këshillit drejtues nga IEAAP, në cilësinë e vëzhguesve, një prind dhe një mësimdhënës.

3.Komisioni përzgjedhës do të veprojë sipas udhëzimeve të parashikuara, respektivisht Udhëzimit Administrativ (MASh) me nr. 151/2020.

4.Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Kuvendi Komunal, për një vit shkollor.

5.Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe arkiva.



Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi